4					
5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmëautoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhëne në këtë tabelë.

PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS⁴

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Nërastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

⁴Kjo deklarate ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënktraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a) *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1*
- b) *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c) *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- d) *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- e) *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- f) *Deklarate mbi përmbushjen e Kriteve të Përgjithshme për Kualifikim sipas shtojcës 8.*
- g) *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*
- h) *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- i) *Deklaratë mbi disponueshmërinë mjeteve sipas Shtojcës 10;*
- j) *Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*
- k) ***Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.***

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

- **Sipas kriteve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (Shtojca 12)**

2.2. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

2.2.1 Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjate tre viteve te fundit **2017, 2018 dhe 2019**, duhet te mos jete me e vogel se **50%** e fondit limit te procedurës se prokurimit. *Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.*

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv te qendrueshem gjate tre viteve te fundit **2017, 2018 dhe 2019**. *Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të tre viteve të fundit (si me siper), të paraqitur pranë autoritetit përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet, **ne te cilat duhet te rezultojë se nuk ka dale me humbje te pakten ne dy vite te nje pasnjeshem**. si dhe te shoqeruara me aktekspertizen e kryer nga Eksperti kontabeli autorizuar.*

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet te paraqese një deklaratë me shkrim nga administratori i subjektit si dhe vërtetim te leshuar nga cdo njesi vendore per te deshmuar se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitet **2019-2020**.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e informacionit te paraqitur. Ne rast deklarimi te rreme do te vepohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

2.3 Per kapacitetin teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë **50%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë tri viteve të fundit (2018, 2019, 2020).
- b) punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit (2018, 2019, 2020) është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

*2.3.1/a Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese **formularët e vleresimit** sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar **me kontraten/kontratat** e nenshkruara nga palet, **situacionet perfundimtare, faturat tatimore, aktet e kolaudimit**. Formulari i vleresimit duhet te percaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes se punëve, dhe faktin nëse kontrata eshte realizuar me sukses.*

*2.3.1.b Në rastin e perves se ngjashme ne sektorin privat kerkohet si deshmi **formularët e vleresimit** sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar **me kontrate** e nenshkruara nga palet, **Leje ndertimi, situacionet perfundimtare, faturat tatimore, akt kolaudimi te objektit,***

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë nje punesim mesatar, me jo më pak se **380 punonjes**, për periudhën (**Qershor 2019 – Nentor 2020**), e vërtetuar kjo me: *Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e kerkuar, shoqeruar me formularët E-SIG te konfirmuara nga organet perkatese (me nenshkrim elektronik ose ne hard copy).*

2.3.3. Operatoret ekonomike duhet te disponojne licensat e nevojshme per zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”. Shqyrtimi i licensave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara sa me siper. Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

- NP – 1/D (Punime germimi ne toke.)
- NP – 4/B (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.)
- NP – 5/B (Punime nentokesore, ura e vepra arti.)
- NP – 6/C (Diga dhe tunele hidroteknike)
- NP – 7F (Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje)
- NP – 9B (Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime)

Dokumenta Standarde të Tenderit

- NP – 11A(Ndertime per N/stacionet , kabinat e transformatoreve linja e TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise)
- NP – 12/D (Punime të inxhinierisë së mjedisit.)
- NS – 1/B (Punime per prishjen e ndërtimeve)
- NS – 5C (Impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut)
- NS – 6C (Sinjalisitika rrugore jo ndricuese)
- NS – 9/E (Punime strukturore speciale)
- NS – 13D (Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni)
- NS – 18/D (Punime topogjeodezike)
- NS -20/C (Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per uje)

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktues dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). **Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.***

2.3.4. Operatori Ekonomik për kryerjen e te gjitha punimeve ne objekt, duhet të ketë te punesuar, minimalisht,

2 (dy)Inxhinier Ndertimi;profili Strukturist

2 (dy)Inxhinier Ndertimi;profili transport;

1 (nje) Inxhinier ndertimi;profili Gjeoteknik

1 (nje) Inxhinier Hidroteknik

1 (nje) Inxhinier Mekanik

2 (dy) Inxhinier Topograf

2 (dy) Inxhinier Elektrik

1 (nje)Inxhinier Gjeolog

1 (nje) Inxhinier Elektronik

1 (nje) Inxhinier Mjedisi me VNM

1 (nje) inxhinier ndertimi me master“Planifikim transporti, menaxhim trafiku dhe siguri rrugore”

1 (nje)inxhinier mekanik me master “Planifikim transporti, menaxhim trafiku dhe siguri rrugore”

1 (nje) inxhinier agrar

1 (nje) inxhinier telekomunikacioni

1 (nje) kimist mjedisi i certifikuar si Pergjegjes per mbrojtjen dhe menaxhimin e demeve ne mjedis

*Për sejcilin pjestar te stafit teknik te mesiperm duhet te paraqese, **Kontrate pune e vlefshme, diplome , Libreze pune dhe CV, te rezultojne te siguruar ne listepagesa për periudhën (Qershor 2019 – Nentor 2020).***

2.3.5. Ofertuesi duhet te paraqese gjithashtu:

- **Nje person (tjeter ose nga personat e mesiperm) te jete i pajisur me certifikate per “Ekspert zjarrfikes” dhe te vertetohet me Kontrate pune e vlefshme, diplome , Libreze pune dhe CV.**
- **1 (nje) Inxhinier (tjeter ose nga personat e mesiperm) Çertifikuar per Sigurimin dhe kontrollin e cilesise ISO9001:2015, me kontrate pune, Certifikate, kopje diploma.**

2.3.6 *Operatori Ekonomik duhet te deklaroje me shkrim se inxhinieret dhe punonjesit e kerkuar ne piken 2.3.3 per kualifikim jane te paangazhuar ne kontrata te tjera.*

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **15** (pesembedhjte) **punonjes manovratore** (nga te cilet **5 Automakinist dhe 10 eskavatoriste/buldozeriste**) dhe **10 shofere te mjeteve te renda** , per te cilet duhet te paraqese **kontrate individuale te punes te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme)/patenten perkatese, leshuar nga institucionet perkatese**, si dhe te figuroje ne lispagesat e shoqerise per te pakten 3 (tre) muajt e fundit. Personat e mesiperm

2.3.8. Operatori ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese leje dhe licensa si me poshte:

* OE duhet të jetë i pajisur me **liçencë nga QKB per Sherbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis, me kod III.2.A (1+2)**

* OE duhet të jetë i pajisur me **liçencë nga QKB per “Transportim i mbetjeve jo te rrezikshme” me kod III.2.B**

* OE duhet të jetë i pajisur me **liçencë nga QKB per “Transportim i mbetjeve te llumrave, ujerave te zeza, ujerave te ndotura urbane dhe ujerave nga gropat septike” me kod III.2.B**

* OE duhet të jetë i pajisur me **liçencë nga QKB me kod III.1.B tipi B per aktivitetin Rikuperim i mbetjeve jo te rrezikshme, stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme "magazininim dhe/ose trajtim i mbetjeve te tjera te ujerave te zeza urbane duke perfshire -llumin nga ujerat e ndotura urbane, - llumin e cisternave septike - mbetjet e ujerave te zeza nga gropat e hapura, - mbetjet nga pastrimi i kanaleve te ujerave te zeza”**

* OE duhet të jetë i pajisur me **liçencë nga QKB per “Shpues profesionist per uje” me kod III.7.B**

2.3.9. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punesuar:

- **2 (dy) punonjës** që disponon çertifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit ne pune”** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 ”Për miratimin e e rregullores ”Për sigurinë në kantier”. **Për specialistin e shoqërisë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për ”Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë”e dhëne nga një organizëm i licencuar certifikimi** shqiptar ose i huaj dhe kontrata e punës e vlefshme, si dhe duhet të jetë i përfshirë në listëpagesen e shoqerise per periudhen **Qershor 2019 – Nentor 2020.**

*Nese ofertuesi do te paraqitet si bashkim operatoresh, sejcili prej operatorëve duhet të ketë të punesuar **1 (një) punonjës** që disponon çertifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit ne pune”***

2.3.10 **Operatori Ekonomik duhet te kete ne përbërje te stafit punonjësit ne përputhje te plote me VKM nr. 632, date 15.07.2015, i ndryshuar.**

Operatori Ekonomik duhet te kete ne perberje te stafit **Nje Mjek ne perputhje te plote me VKM nr.108 date 09.02.2011**, i ndryshuar, te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, diplome CV, leje ushtrimi profesioni te leshuar nga Urdheri i Mjekut.

- *Secila nga kategorite e mesiperme (pika 2.3.3 deri ne 2.3.10) duhet te kete dhe nje liste te punonjesve per cdo kategori kerkese me dokumentacionin e kerkuar bashkangjitur.*

2.3.11 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. *Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik.*

<i>Nr</i>	<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
1	Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës 18 – 20 ton	4 Cope	Pronësi ose me qera
2	Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës minimum 20 ton	8 cope	Pronësi ose me qera
3	Eskavator me zinxhir me kove 0.3 m ³	7 Cope	Pronësi ose me qera
4	Eskavator me krah te gjate min 12m	3 Cope	Pronesi ose me qera
5	Kamionçine me kapaciteti mbajtës 2-4 ton	5 cope	Pronësi ose me qera
6	Fadrome me goma me kove para dhe mbrapa	2 copë	Pronësi ose me qera
7	Eskavator me goma me kove 0.25 m ³	2 Cope	Pronësi ose me qera
8	Autovinc	3 cope	Pronësi ose me qera
9	Autovinc me kapacitet min 10 Ton	2 Cope	Pronësi ose me qera
10	Rrul hekuri per ngjeshje deri ne 2 Ton	1 cope	Pronësi ose me qera
11	Fshese per asfaltin	2 Cope	Pronësi ose me qera
12	Prerese Asfalti	2 cope	Pronësi ose me qera
13	Asfaltoshtruese	1 Cope	Pronësi ose me qera
14	Autobitumatrice	1 Cope	Pronësi ose me qera
15	Rrul hekur – hekur (me kapacitet 8 – 10 Ton)	2 Cope	Pronësi ose me qera
16	Rrul Vibrues Gome – Hekur (me kapacitet 9 – 12Ton)	2 Cope	Pronësi ose me qera
17	Rrul me gunga Gome – Hekur (kapacitet 10-12 Ton)	1 Cope	Pronësi ose me qera
18	Paisje per ngjitjen e Tubave HDPE - 613mm	3 Cope	Pronësi ose me qera
19	Paisje per testimin e linjese se tubave me presion – 16 Bar	1 cope	Pronësi ose me qera
20	Minifadrome me kove para	2 cope	Pronësi ose me qera
21	Well Point ITT	5 Cope	Pronësi ose me qera
22	Matrapik me fuqi min 2000W	2 cope	Pronësi ose me qera
23	Motogjenerator me fuqi min 200 kVA	2 cope	Pronësi ose me qera
24	Autokulle per ndricimi kantier	1 cope	Pronësi ose me qera
25	Saldatrice me argon 400A	1 Cope	Pronësi ose me qera
26	Makineri per nguljen e palankolave	1 Cope	Pronësi ose me qera

Dokumenta Standarde të Tenderit

27	Trencher me zinxhir per hapje kanali fuqi min 180 kW	1 cope	Pronësi ose me qera
28	Total station + GPS te certifikuar sipas standartit european ISO17123-3,ISO 17123-4	1 Cope	Pronësi ose me qera
29	Set laboratorik per testimin e asfaltit,bitumit,betonit,gureve dhe llojeve te ndryshme te dherave sipas Direktivave europiane(2006/42/CE , 2014/35/UE , 2014/30/UE/ , BS 1377:2 , BS6576 + Certifikate konformiteti	1 Cope	Pronësi ose me qera ose kontrate sherbimi
30	Fabrike per prodhimin e pusetave 1000x1000x1500 me certifikat cilesie SSH EN1917	1 Cope	Pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi.

- a) **Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet:** a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit per te trete dhe me qera (e vlefshme).
- c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperme, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve.
- d) Për fabriken e pusetave nese eshte ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, leja mjedisore leshuar nga QKL. Nese eshte marre me qera krahas dokumentacionit te mesiperme, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases. Operatori ekonomik per fabriken e pusetave mund te paraqese edhe kontrata te vlefshme furnizimi me operatore ekonomike Ne kete rast duhet te paraqese kontraten e furnizimit dhe dokumentacionin qe verteton ekzistencen dhe pronesine e impiantit sipas dokumentacionit me lart te kerkuar.
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së kontrates.
- f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe te beje deklarimin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre”
- g) Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera me autoritetin kontraktues. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese se makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera.

2.3.14 Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese çertifikatat te vlefshme si me poshte:

- *EN-ISO 14001:2004 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit)*
- *EN- ISO 9001-2015 (Sistemi i menaxhimit te cilesise)*
- *EN-OHSAS 18001:2007 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)*
- *ISO 39001:2012 (Sistem i menaxhimitte sigurisë rrugore dhe trafikut)*
- *SA 8000:2014 (Sistemi i pergjegjesise sociale)*

Te gjitha certifikata e mesiperme duhet te jene te lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Nese ofertuesi do te paraqitet si bashkim operatoresh, certifikatat duhet te jene ne perputhje me punimet e marra persiper.

2.3.15 Operatori ekonomik per **Tuba Te brinjezuar HDPE SN8** duhet te paraqese:

1. Autorizim te prodhuesit/ve/distributor/ve per listen e mesiperme te mallrave. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. (Ne rastet kur autorizimi eshte ne gjuhe te huaj duhet te behet perkthimi ne gjuhen shqipe dhe noterizimi i tij.)

Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata e angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit . (të përkthyer në shqip dhe te noterizuara).

2. Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve e prodhuesit/ve per listen e mesiperme, ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen.

3. Shoqeria prodhuese duhet te kete certifikate ISO 9001:2015 , ISO 14001:2015 (ku te cilesohet ne fushen e aktiviteti prodhimi i tubave) , dhe certifikatat e konformitetit per tubat.

- **Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogut te prodhuesit dhe ti jape mundesine Autoriteti kontraktor te gjurmoje on-line keta kataloge/fragmente katalogesh.**

2.3.16 Operatori ekonomik duhet te kete kontrate me nje laborator testimi te betonit, i cili duhet te jete i akredituar nga organizma kombetar ose nderkombetar sipas standarteve SSH EN 12390-3:2009 ose ekuivalente , SSH EN 12504-4:2008 ose ekuivalente, SSH EN 12350-2:2009 ose ekuivalente dhe SSH EN 12504-2:2012 ose ekuivalente

Detyrimisht te paraqitet kontrata noteriale si dhe dokumenti i akreditimit se bashku me standartin perkates.

2.3.17. Operoret e huaj ekonomike, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuara “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e

kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.

2.3.18. Kandidatët/ofertuesit duhet të përmbushin kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 ”Për prokurimin publik”i ndryshuar. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kandidatët/ofertuesit duhet t`i përmbahen VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. **Per kete qellim duhet te paraqitet dekrata sipas shtojces 8.** Autoriteti kontraktor ka te drejten te beje verifikime mbi deklarimet e ofertuesve.

2.3.19. Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, *duhet t`i përmbahen nenit 74, te VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. i ndryshuar.* duhet te dorezohet marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht ku te kene specifikuar dhe punimet qe do te kryeje sejcili nga operatoret pjesemarres ne BOE-se dhe Prokura e posaçme. **Çdo anëtar i grupit, duhet të dorëzojë dokumentat e kerkuara, ne perpjestim dhe perputhje me punet e marrra perisiper sipas marrevshjes se bashkepunimit.**

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim

Shtojca 13

(Shtojcë për t`u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike tëpunëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Dokumenta Standarde të Tenderit

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve:

SIPAS MATERIALEVE BASHKENGJITUR

Grafiku i Punimeve:

SIPAS MATERIALEVE BASHKENGJITUR

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

SIPAS MATERIALEVE BASHKENGJITUR

Shtojca15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁵

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

<Emri>

⁵ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TËFITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumenta Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimine kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomike më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Dokumenta Standarde të Tenderit

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Perkatësisht për arsyt e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS
Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotësuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afatii realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.

- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkuara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkëlqje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vëne re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.
